

Akademia Shkencore e Mjekësisë Preventive

Shqiptare

Tekste informative nga bllokun i çeqeve „Gesundheit für Eltern und Kind“ versioni 2024

Përse e keni marrë bllokun e çeqeve „Gesundheit für Eltern und Kind“ (Shëndeti për Prindërit dhe Fëmijën), dhe çfarë shkruan në të?

Me këtë bllok çeqesh ju i merrni falas vaksinat më të rëndësishme për fëmijën tuaj. Ju lutemi, merrni këtë bllok çeqesh patjetër me vete, kur Ju shkoni bashkë me fëmijën tuaj tek mjeku specialist i fëmijëve/mjekja specialiste e fëmijëve ose tek mjeku i familjes/mjekja e familjes. Me pjesët e kuponëve në këtë bllok Ju merrni falas si vaksinën në farmaci ashtu edhe vaksinimin tek mjeku/mjekja. Kështu, fëmija juaj është i mbrojtur në mënyrë të sigurt ndaj sëmundjeve më të rëndësishme ngjitëse. Përkthimet e teksteve më të rëndësishme në këtë bllok çeqesh i gjeni këtu:

Në faqen 4 thuhet:

Kështu e përdorni Ju këtë bllok çeqesh

Ky bllok çeqesh është shumë i vlefshëm për Ju dhe për fëmijën tuaj. I njëjti përmban kupone në vlerë të përgjithshme mbi 900 Euro për fushatën e vaksinimit falas të Landit, Federatës dhe të Institucioneve të Sigurimit Shëndetësor për fëmijët tuaj. Për t'i përdorur këto shërbime fëmijën duhet ta lajmëroni në aksionet gratis të vaksinimit dhe në bazën e të dhënave të vaksinimit në Steiermark.

Ju lutemi, që për këtë të plotësoni fletën e të dhënave (djathtas) tërësisht dhe të lexueshme mirë dhe t'a nënshkruani atë në kutinë poshtë djathtas. Mjekja/mjeku ose stafi i spitalit e shkëpusin këtë pjesë. Në bllok mbetet vetëm kopja. Vetëm pasi të jetë bërë kjo, fëmija juaj është i regjistruar dhe bllokun bëhet i vlefshëm. Kur Ju do të merrni vaksinën në dorëzim, pjesa „Rezept“(recetë) do të veçohet menjëherë prej bllokut nga farmacia. Për vaksinimin tek mjeku do të shkëputen pjesët „Impfgutschein“ (kupon i vaksinimit) dhe „Impfbestätigung“ (vërtetimi mbi vaksinimin). Kështu, sigurohet, që Ju nuk duhet të paguani për këto vaksinime as në farmaci dhe as tek mjeku. Pjesa „Impfmeldung“ (lajmërimi i vaksinimit) qëndron në bllok, në mënyrë që Ju t'a dini se cilat vakcina ka marrë fëmija juaj, kur dhe prej kujt. Nëse nuk e keni me vete librezën në farmaci, Ju mund t'a merrni vaksinën vetëm kundrejt recetës private dhe me shpenzimet tuaja. Edhe tek mjeku Ju duhet të paguani tarifën e vaksinimit, në rast se do të keni harruar bllokun. Mjekja/mjeku dhe farmacia do t'ua kthejnë paret mbrapsht, nëse bllokun e çeqeve do t'a çoni më pas. Kuponat janë të vlefshme për mjekët/ mjeket specialistë për fëmijë dhe e mjekun/ mjeken e përgjithshëm/ e përgjithshme, si edhe në të gjitha autoritetet e rrethit (seksionet sanitare) në Steiermark, në qendrat e vaksinimit të landit dhe në seksionin e shëndetësisë të Këshillit Bashkiak të qytetit Graz.

Vini re: Pjesët e shkëputura (d.mth. tashmë të veçuara) janë të pavlefshme, si rezultat pa vlerë!

Ju lutemi, që librezën e vaksinimeve patjetër t'a merrni me vete në vaksinim.

Në faqen 5 është paraqitur fleta e shënimeve me ç'rast ju duhet të plotësoni këto pika:

- Numri i sigurimit social dhe data e lindjes të kujdestarit
- Mbiemri i/e kujdestarit/es
- Emri i/e kujdestarit/es
- Adresa
- Numri postal & vendi
- Numri i telefonit mobil
- Adresa elektronike
- Mbiemri i fëmijës
- Emri i fëmijës
- Numri i sigurimit social, data e lindjes dhe gjinia e fëmijës
- Në fushën e poshtme majtas: vula dhe nënshkrimi i institucionit shëndetësor resp. mjekja/ mjeku
- Në fushën pranë djathtas: Data, vendi & nënshkrimi i/e kujdestarit/es

Në faqen 6 thuhet:

Konfirmimi dhe marrje dijoni për kujdestarët

Fushata e vaksinimit falas & Baza e të dhënave për vaksinimin:

Unë konfirmoj, se kam regjistruar fëmijën tim në bazën e të dhënave të vaksinimit dhe fushatat falas të vaksinimit të landit Steiermark. Kështu, automatikisht fitoj qasje në fushatat e vaksinimit falas të landit Steiermark. Në këtë mënyrë, vaksinat dhe vaksinimet tek mjeku/ mjekja janë falas. Vaksinat, që bëhen në kuadrin e fushatave të vaksinimit falas të landit, përshtaten vit pas viti me rekomandimet e zbatueshme aktualisht në planin vaksinues austriak. Unë marr në dijeni që të dhënat personale dhe ato të vaksinimit, të nevojshme për përpunimin dhe kompensimin e fushatave të vaksinimit falas të përpunohen dhe regjistrohen elektronikisht në bazën e të dhënave të vaksinimeve të landit Steiermark. Nëse unë nuk do të jem dakort me përpunimin elektronik, atëherë unë, respektivisht fëmija im nuk mund të merr pjesë në fushatën e vaksinimit falas. Të dhënat e mia në bazën e të dhënave të vaksinimit përdoren vetëm për fushatën e vaksinimit falas dhe Shërbimin Informativ Prind-Fëmijë (shih poshtë). Pavarësisht nga kjo, të dhënat e vaksinimit duhet të regjistrohen në regjistrin austriak të vaksinimit nga

mjeku vaksinues ose mjekja e vaksinuese. Unë lejoj, që mjekët/mjeket dhe spitalet e autorizuar në rrejtin stirian të vaksinimit, të shohin në internet ose të marrin informacion përmes telefonit, se cilat vaksinime janë të dokumentuara për fëmijën tim në bazën e të dhënave të vaksinimeve. Kundrejt kërkesës me shkrim, unë marr informacion lidhur me atë, se çfarë të dhënash janë të regjistruara për mua dhe fëmijën tim në bazën e të dhënave stiriane të vaksinimeve. Unë, respektivisht fëmija im, mund të çregjistrohet në çdo kohë me shkrim nga fushata e vaksinimit falas dhe nga baza e të dhënave. Informacione të gjëra lidhur me mbrojtjen e të dhënave në bazën e të dhënave të vaksinimit të landit Leteiermark, unë mund t'i lexoj nën: www.vorsorgemedizin.st. Unë vërtetoj që kam marrë bllokun e çeqeve „Shëndeti për prindërit dhe fëmijën 2024“ së bashku me kuponat e vaksinimit për fushatën e vaksinimit falas, dhe që të dhënat e mia përpara janë të plota dhe të sakta dhe se ende nuk kam marrë bllokun e çeqeve të vaksinimit për fëmijën tim të përmendur përpara. Unë marr dijeni, që për shembull në rast humbje, nuk kam të drejtën e një blloku tjetër, dhe që duhet t'i zëvendësoj shpenzimet e landit Steiermark, në rast se unë do të marr një bllok të dytë. Kështu, vaksinat dhe vaksinimet duhet të paguhen vetë.

Shërbimi Informativ Prindër-Fëmijë: Të dhënat e ruajtura në bazën e të dhënave të landit Steiermark do të përdoren gjithashtu edhe për shërbimin informativ Prindër-Fëmijë: Në këtë mënyrë, unë marr rregullisht dhe falas informacione, me shkrim në lidhje me librezën prindër-fëmijë dhe datat e vaksinimit, të rekomanduara për secilin, si edhe lidhur me kujdesin shëndetësor për fëmijë. Unë lejoj, që të informohem rregullisht, me shkrim dhe falas në lidhje me librezën Prindër-Fëmijë dhe datat e vaksinimit, si edhe lidhur me kujdesin shëndetësor. Unë mund të çregjistrohem në çdo kohë me shkrim nga shërbimi informativ Prindër-Fëmijë. Aksesi në fushatën e vaksinimit nuk është e prekur nga kjo. Unë lejoj mjekun dhe spitalin, që të më çregjistrojë mua ose fëmijën tim nga shërbimi informativ, nëse ekzistojnë arsye personale ose mjekësore, dhe që ndryshimet e të dhënave që janë të rëndësishme për programin e vaksinimit ose për librezën Prindër-Fëmijë, t'ia transmetojë shërbimit informativ Prindër-Fëmijë dhe atij të vaksinimit.

E rëndësishme: Pjesët e kuponit vlejnë vetëm, nëse ato do të shkëputen direkt tek mjekja/mjeku ose në farmaci. Gjatë transportit nga farmacia për tek mjeku vaksina duhet të mbahet e ftohtë, por nuk duhet të ngrihet!

Udhëzim për mjekët/mjeket: Të gjitha të dhënat duhet të jenë të plota dhe të lexueshme mirë. Si nënshkrimi i pranuesit (zakonisht njëri prind), ashtu dhe vula e klinikës mjekësore dhe nënshkrimi i mjekut/mjekes duhet të plotësohen me patjetër në faqen e parë, në mënyrë që kuponat e vaksinimit të dorëzohen dhe të kompensohen. Lutemi të ndani origjinalin e fletës së të dhënave nga librezat dhe t'ia dërgoni atë meoemos Akademisë Shkencore për Mjekësinë Preventive. Radetzkystraße 9/1, 8010 Graz. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi na telefononi: Tel. 0316/829727, Fax 0316/831411, email: akademie@vorsorgemedizin.st

Në faqen 9 thuhet:

Vetëm vaksinimi mbron: Në kohë të duhur!

Shumë sëmundje ngjitëse (infeksione), që kanë ecuri të rëndë, nuk mund të trajtohen dot në mënyrë kauzale, por ato kanë mundësi të lehtësojnë vetëm shenjat, respektivisht simptomat e sëmundjes. Kjo vlen si për “mjekësinë shkollore” ashtu edhe për “mjekësinë plotësuese”. Prandaj vaksinimi është e vetmja mbrojtje e efektshme. Prandaj, vaksinimi në kohën e duhur është shumë i rëndësishëm! “Terminet e rekomanduara për vaksinim” i përkasin gjithmonë njohurive më të fundit të shkencës mjekësore. Ato janë rekomandime për kohën më të përshtatshme. Nëse kjo ditë nuk mund të realizohet për ndonjë arsye, çdo vaksinim mund të bëhet në ditën tjetër të mundshme. Mjekja ose mjeku juaj do t'ju ofrojë me kënaqësi informacione më nga afër.

Më poshtë do të gjeni pasqyrën lidhur me vaksinat dhe afatet e rekomanduara të vaksinimit.

Në faqen 10 thuhet:

Libreza Nënë-Fëmijë & Shërbimi informues Prindër-Fëmijë

Libreza Prindër-Fëmijë...

...shtë lloji udhërrëfyesi për përkujdesje mjekësore të grave shtatzëna dhe fëmijëve deri në moshën pesëvjeçare. Libreza e plotësuar Prindër-Fëmijë ofron të dhëna për gjendjen shëndetësore të nënës dhe fëmijës. Libreza mundëson edhe zbulimin e rreziqeve të përgjithshme dhe trajtimin respektiv të tyre. Ndihami mjekësore nuk duhet të vonohet asnjëherë. Pra është shumë me rëndësi ti respektoni të gjitha terminet nga Libreza Prindër-Fëmijë.

Në përgjithësi kontrollet nga Libreza Nënë-Fëmijë bëhen deri në moshën pesëvjeçare – dhe kjo për arsye të fortë. Është me rëndësi që të përcillet zhvillimi i shëndetit në mënyrë që fëmija juaj të mos ketë rreziqe shëndetësore të pazbuluara qoftë në çerdhe të fëmijëve ose në moshën parashkolllore dhe të këtë zhvillim të mirë trupor. Pra, shfrytëzoni këtë ofertë – në kohë dhe orar të duhur. Përndryshe, të gjitha kontrollet nga Libreza Prindër-Fëmijë janë gratis. Edhe nëse nuk jeni të siguruar, pranë Sigurimit Shëndetësor Austriak mund të merrni certifikatën sigurimi.

SHËNDETI, PO SI!

Magazinën për prindër të Akademisë Shkencore për Mjekësinë Preventive e keni pa pagesë dhe automatikisht nëse posedoni Bilokun e Çeqeve “Shëndeti për Prindër dhe Fëmijë”. Nëse nuk e posedoni Librezën e Vaksinimit mund ta merrni gratis broshurën “SHËNDETI, PO SI” sipas kërkesës (Tel.: 0316 / 829727)

Shërbimi informues Prindër-Fëmijë..

...ju informon - në rast se dëshironi – me kohë dhe para Librezës Prindër-Fëmijë dhe termineve të vaksinimit lidhur me preventivën shëndetësore për fëmijën tuaj – në kohë të duhur dhe gratis!

Informacione shtesë:

Tel. 0316 / 82 97 27

Në faqen 11 thuhet:

Këshillime për prindër

Që çështjet e vogla të mos shndërrohen në probleme të mëdha

Landi Steiermark ka në funksion shumë qendra këshillimore për Nëna-Prindër si dhe qendra këshillimore për prindër (ebz) në rrethet e Landit. Qëllimi i tyre është të ndihmojnë prindërit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël gjatë përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve.

Ofertat nisin me kontrollet mjekësore, këshilla për kujdes dhe të ushqyerit e duke përfshirë ofertat për preventivë psikosociale (p.sh. takime prindër-fëmijë, grupe të gjdhënies, ligjërata etj.) Qendrat ju garantojnë këshilla profesionale nga mjeket/ mjekët, punëtorët socialë, mamitë e diplomuara, motrat për foshnja si dhe profesionistë të tjerë nga fusha Prind-Fëmijë. Kështu përkrahet që nga fillimi shëndeti trupor, shpirtëror dhe social. Informacione të sakta gjeni tek punëtorët socialë të administratës së rrethit tuar ose pranë Magistratit në Graz.

Në faqen 12 thuhet:

Shërbimet e këshillimit psikosocial

Përgjatë zhvillimit të shumë fëmijëve ndonjëherë ka raste kur prindërit nuk janë plotësisht të sigurt nëse gjithçka është në rregull. Nëse jeni të shqetësuar ose keni pyetje lidhur me aftësitë e kufizuara, probleme zhvillimi, probleme të sjelljes, probleme të folurit ose edukimit, ju do të keni në dispozicion shërbime për këshilla, informacione dhe shërbime mbështetëse ku ekspertët/ ekspertet mund të këshillojnë për mirëqenien fizike, mendore dhe sociale të fëmijëve. Ata gjithashtu japin informacion për ofertat e tjera mjekësore psikosociale dhe sociale në rrethe.

Linja sociale dhe pika e shërbimit të Landit Steiermark

Tel 0800 / 20 10 10 pa pagesë

Ne ofrojmë informacione të përgjithshme, ndërmjetësojmë dhe koordinojmë pyetjet në lidhje me përgjegjësitë dhe të gjitha shqetësimet që lidhen me sektorin social. Ne gjejmë kohë për të dëgjuar shqetësimet tuaja dhe, nëse është e nevojshme, ia përcjellim pyetjet zyrës përgjegjëse.

Qendra e pedagogjisë terapeutike e Landit Steiermark

Tel (0316) 28 42 18 – 331, email: hpz@stmk.gv.at.

Fëmijët dhe të rinjtë shpesh kalojnë nëpër faza të stuhishme të zhvillimit personal, të cilat ndonjëherë shoqërohen me konflikte më serioze. Në këto faza, fëmijët mund të mbingarkohen dhe, më së voni, te një rast i tillë ju duhet ndihmë profesionale.. Qendra e pedagogjisë terapeutike është një institucion i mirëqenies për fëmijët dhe të rinjtë në shtetin e Steiermark dhe ka një zonë stacionare, një zonë të gjysmë-stacionare dhe dhe një qendër këshillimi psikoterapeutik.

Në faqen 13 thuhet:

Siguria për fëmijën tuaj

Çdo vit, një në pesë fëmijë në Austri duhet të trajtohet në spital pas ndonjë aksidenti. Më se gjysma e aksidentëve ndodhin në shtëpi. Çdo dy - tre javë vdes një fëmijë si pasojë e një aksidenti.

Me listën kontrolluese të shoqatës GROSSE SCHÜTZEN KLEINE

mund të kontrolloni shtëpinë tuaj për sigurinë e fëmijëve:

www.grosse-schuetzen-kleine.at/gsk/service

Djegjet

Kuzhina është vend shumë i dashur për familjen - për fat të keq, aty ndodhin shumë aksidente të rënda të fëmijëve (p.sh. djegie, përvëlime) e të cilat lehtë parandoalohen.

Këshilla:

• Instaloni mbrojtëse të pllakave dhe siguresa të furrës • Asnjëherë mos mbani, hani ose pini ndonjë gjë të nxehtë pranë ose mbi fëmijën tuaj.

Rrëzimet nga lartësia

Rrëzimet nga dritarja janë ndër aksidentet e fëmijëve me pasojat më të rënda. Bllokimi i dritares është preventiva më e rëndësishme sigurorese. Mund të shpëtojë jetë dhe të shmangë lëndimet serioze.

Këshilla:

Akademia Shkencore e Mjekësisë Preventive

Radetzkystraße 9/1, 8010 Graz
Tel. 0316/82 97 27 • Fax 0316/83 14 11
akademie@vorsorgemedizin.st
www.vorsorgemedizin.st

ZVR 485850183
DVR 0961931

Faqe 3 nga 9

- Instaloni siguresa bllokuese në dritare dhe dyer të ballkonit • Mos e largoni nga sytë fëmijën kur të ajrosni dhomën
- Instaloni portë mbrojtëse për shkallë
- Mos e lini të vetmuar fëmijën tuaj në tavolinën e ndërrimit.

Mbytja në ujë

Mbytja në ujë është shkaktari kryesor i aksidenteve me vdekje të fëmijëve në Austri! Ndodh shpejt, pa shurmë edhe në ujëra shumë të cekëta. Mbikëqyrni pandërprerë dhe me vëmendje të plotë fëmijët brenda dhe përreth ujit!

Këshilla:

- Mos e lini kurrë fëmijën tuaj pa mbikëqyrje në vaskë ose pishinë fëmijësh ose bazen
- Nëse ka ndodhur aksidenti duhet t'i jepni fëmijës menjëherë frymëmarrje artificiale në mënyrë që truri të furnizohet sërish me oksigjen. Vizitoni një kurs për aksidente të fëmijëve.

Fëmijët e sigurtë gjatë udhëtimit tuaj

Mbroni fëmijën tuaj në trafikun rrugor dhe gjatë sportit:

Sediljet e makinave dhe helmetat e përshtatshme në moshë mund të shpëtojnë jetë.

Këshilla:

- Siguroni fëmijën tuaj me ulëse të përshtatshme për moshën gjatë vozitjes me veturë
- Vendosni fëmijës tuaj helmetë gjatë sporteve me rrota dhe cilindra ose sporteve dimërore

Kujdes gjatë takimit me qen:

Asnjëherë mos i leni të vetëm fëmijët e vegjël me qenë!

Shoqata GROSSE SCHÜTZEN KLEINE

Tel. 0316 / 385 13764 – www.grosse-schuetzen-kleine.at

www.kindersicherheitshaus.at

Në faqen 14 thuhet:

Mos bëni panikë në rast aksidentit!

1. Shpëtoni fëmijën nga situata e rrezikut aktual (p.sh. nga uji)
2. Thirrni për ndihmë me zë të lartë
3. Filloni menjëherë me masat emergjente për shpëtim
4. Thirrni ambulancën

NUMRAT TELEFONIK EMERGJENT

Ndihma e shpejtë:	144
Euro-Emergjencia në tërë EU-në:	112 (Policia, shpëtimi, zjarrfikësit)
Zjarrfikësit:	122
Policia:	133

Shërbimet emergjente

Shërbimi shëndetësor	1450
Shërbimi mjekësor emergjent (shtuar prefiks lokal)	141
Qendra informuese për helmime	01/4064343
Ambulanca emergjente e Klinikës së Fëmijëve Graz	0316/385-82636
Laboratori i gjumit, Klinika e Fëmijëve Graz	0316/385-13747
Baby-Hotline Klinika e Fëmijëve Leoben	03842/401-2570
Shërbimi mobil pediatrik	0316/813181-4610
Shërbimi për familjen pranë Kancelarit Federal (gratis)	0800/240 262
Helpline për gratë: kundër dhunës nga burrat (gratis)	0800/222 555
Rot-Minus-Kreuz-Kurse: Ndihma e parë në rast të aksidenteve të fëmijët	0800/222 144

Hapat e drejtë të masave të ndihmës së parë

Kontrolloni vetëdijen: Flisni fëmijës me zë të lartë dhe tundeni lehtë në shpatulla

Fëmija është pa ndjenja:

Thirrni për ndihmë!

Pastroni rrugët e frymëmarrjes:

Tërhiqeni kokën e fëmijës, ngritni mjekrrën lart

Kontrolloni frymëmarrjen e tij maksimalisht 10 sekonda:

shiko, dëgjo, ndjej

Fëmija nuk merr frymë normalisht:

5x frymëmarrje artificiale: gojë më gojë ose gojë më hundë:

Me kokën paksa të tejzgjatur jepni frymëmarrje artificiale 5 x në mënyrë që gjoksi dhe barku të ngrihen si në frymëmarrjen normale.

30x masazh zemre: vendosni pëllëmbën e dorës tuaj (tek foshnjat 2 gishta) në mes të gjoksit dhe drejtoni dorën tuaj. Shtypni shpejt dhe fort.

2x frymëmarrje, pastaj përsëri **30x** masazh kardiak, etj.

Nëse jeni vetëm, thirrni ambulancën pas 1 minute.

thirrni ambulancën (144); pastaj përsëri 30x masazh zemre & 2x frymëmarrje artificiale; vazhdoni derisa fëmija të zgjohet ose të marrë frymë normalisht.

Për plagët me gjakderdhje të madhe: mbani lart pjesën e gjakosur të trupit; bëni presion në plagë; eventualisht aplikoni një fashë presioni

Fëmija është i vetëdijshëm:

Vëzhgoni më tutje fëmijën, vendosje në pozitë të rehatshme, siguroni ajrosje të mirë, mbuloni, kujdesuni

Thirrni ambulancën: Tel 144

Fëmija merr frymë normalisht:

Vendoseni fëmijën pozitë stabile anësore

Thirrni ambulancën: Tel 144

Burimi: *Notfall- und Katastrophenmedizin Land Steiermark; 2021 Faqe 15*

Nga faqja 15 deri 18 thuhet:

Informacione lidhur me vaksinimin të Departamentit 8 Shëndeti & Kujdesi

VAKSINIMET FALAS PËR FOSHNJAT DHE FËMIJËT E VEGJËL

Me kuponat në këtë bllok, të gjithë fëmijët marrin falas vaksinimet e mëposhtme:

Vaksinimi 6-fish (difteria, tetanozi, poliomieliti, kolla e mirë, hemofilus influenza tip B, hepatiti B), fruthi, shytat, rubeola, vaksina e kombinuar (MMR), rotaviruset (vaksinimi me gëlltitje), vaksinimi i konjuguar kundër pneumokokëve (PNC). Tek secila nga këto vaksina janë të nevojshme vaksinimet e pjesëshme, përkatësisht rifreskimet, për të siguruar mbrojtjen për kohë të gjatë. Nëse njëra nga vaksinat nuk kryhet në ditën e caktuar, është e rëndësishme që ajo të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Vaksinimi i 6-fishtë

Pjesa 1-rë e vaksinimit të pjesëshëm vijon normalisht në muajin e 3-të të jetës, pjesa e 2-të e vaksinimit të pjesëshëm në muajin e 5-të të jetës, pjesa e 3-të e vaksinimit të pjesëshëm prej muajit të 11-të (deri 12-të) të jetës, në fakt jo më herët se 6 muaj pas pjesës së 2-të të vaksinimit të pjesëshëm.

Vaksinimi kundër fruthit, shytave dhe rubeolës (MMR)

Me vaksinimin e parë në muajin 10-të deri të 12-të të jetës, vaksinimi i dytë i pjesëshëm pason në distancë kohore prej 3 muajsh. Nëse vaksinimi i parë i pjesëshëm vijon pas moshës 1 vjeçare, për vaksinimin e dytë duhet të respektohet një distancë kohore minimale prej 4 javësh. Nëse mungon vaksinimi i 1-rë/ose i 2-të i MMR, atëherë këto mund të bëhen më vonë në çdo moshë brënda fushatës së vaksinimit gratis.

Vaksinimi me gëlltitje kundër rotaviruseve

Rotaviruset janë shkaktarët më të shpeshtë të diarresë me vjellje (gastroenteritisit) tek foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Ato shkaktojnë më shumë se gjysmën e sëmundjeve të diarresë të kësaj grupmoshe (kryesisht në dimër). Sa më i vogël të jetë fëmija gjatë infeksionit të parë, aq më e rëndë llogaritet ecuria e sëmundjes tek ai. Prandaj, vaksina me gëlltitje kundër rotaviruseve duhet të merret mundësisht sa më herët – pas mbushjes së moshës 6-javore -. Në varësi të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, në fushatën e falas të vaksinimit qëndron në dispozicion Rotarix® ose Rotateq®. Të dyja vaksinat mund të jepen që nga mosha 6-të javëshe. Në varësi të vaksinës fëmijët do të marrin 2 vaksina të pjesëshme (Rotarix®) ose 3 vaksina të pjesëshme (Rotateq®). Me javën e 24-të të jetës (Rotarix®) përkatësisht 32-të të jetës (Rotateq®) duhet të përmbillet seria e vaksinimit. Nuk është parashikuar ndërrimi ndërmjet vaksinave.

Për 2024 keni në dispozicion falas Rotarix®.

Pneumokoket: Vaksinimi i shumëfishtë i konjuguar (PNC)

Në dy vitet e para të jetës, sëmundjet pneumokokale me ecuri shumë të rëndë (invazive) me helmim gjaku ose meningjit purulent, janë ndër infeksionet më të shpeshta kërcënuese për jetën dhe arsyet për dëmtimet e përhershme. Prandaj, vaksinimi i PNC-së sipas planit austriak të vaksinimit është i rekomandueshëm për të gjitha foshnjat që nga mosha 3 muajshe deri në moshën 2-vjeçare, dhe për fëmijët me rrezikshmëri deri në moshën 5-vjeçare.

Fillimi i hershëm i marrjes së serisë së vaksinimit në muajin e 3-të të jetës rekomandohet gjithsesi. Sepse: rastet më të shumta të meningjitit pneumokok shfaqen në vitin e 2-të të jetës.

Pjesa e 1-rë e vaksinimit të pjesëshëm bëhet në muajin e 3-të të jetës, pjesa e 2-të në muajin e 5-të të jetës dhe pjesa e 3-të në muajin e 12-të (deri 14-të) të jetës, d.m.th. 7 deri në 9 muaj pas vaksinimit të 2-të të pjesëshëm. Vaksinimi PNC mund të jepet në të njëjtën kohë me vaksinën 6-fish. Nëse vaksina e 1-rë e pjesëshme vijon në vitin e 2-të të jetës, rekomandohen vetëm 2 vaksinime në distancë kohore të paktën prej 8 javësh. Fëmijët me rrezik të

Iartë mund ta marrin vaksinimin PNC falas deri në moshën 5 vjeçare. Ekzistojnë disa lloje të vaksinave PNC. Në v. 2024 do të përdoret vakcina 15-valente Vaxneuvance® për vaksinat falas. (Kutia poshtë tregon skemën e vaksinimit, në varësi me fillimin e vaksinimit fillestar).

Influenza (gripi i vërtetë viral)

Vaksinimi rekomandohet dhe ka kuptim për fëmijët që nga moshja 7 muajshe. Në veçanti, fëmijët me rrezikshmëri të shtuar nga sëmundjet kronike të mushkërive, zemrës, metabolizmit, sëmundjet e veshkave dhe defekteve të lindura ose të fituara imunitare duhet të vaksinohen kundër gripit. Vaksinimi kundër gripit deri në moshën 18 vjeçare do të ofrohet në programin e vaksinimit falas në vjeshtë/dimër 2024/2025 përmes programit të vaksinimit. Për këtë proces nuk ju duhet ndonjë kupon nga blloku i çeqeve.

Corona

Vaksinimi mbrojtës kundër koronës ul rrezikun e sëmurjes rëndë nga COVID-19. Përveç kësaj rreziku për pasoja afatgjata të sëmundjes është më i vogël te personat e vaksinuar se te ata të pavaksinuar. Nëse sëmurëni nga COVID-19 përkundër vaksinimit, ecuria e sëmundjes është parimisht më e shkurtër dhe më e butë. Edhe komplikimet, qëndrimet në spital dhe vdekjet gjithashtu mund të shmangen në masë të madhe. Vaksinimi kundër COVID-19 është pa pagesë dhe lejohet që nga moshja 6 muajshe. Vaksinimi përgjithësisht rekomandohet nga moshja 12 vjeç dhe është i mundur nga moshja 6 muajshe. Vendimi për vaksinë kundër koronës duhet të merret gjithmonë në konsultim me mjekun/mjekën trajtues të fëmijëve, duke marrë parasysh edhe situatën individuale.

VAKSINIME TË TJERA TË RËNDËSISHME PËR FOSHNJAT DHE FËMIJËT E VEGJËL

Përveç vaksinimeve që Ju i përfiton falas përmes këtij blloku të çeqeve, plani austriak i vaksinimit rekomandon për të gjitha foshnjat dhe fëmijët e vegjël edhe vaksinimet e tjera, të cilat duhen të paguhën nga vetë Ju. Ju lutemi që të bisedoni me mjekun/mjekën, se cilat do të ishin të dobishme dhe të nevojshme për fëmijën tuaj.

Meningokoku

Vaksinimi kundër meningokokus B rekomandohet për të gjithë fëmijët, mundësisht pas përfundimit të muajit të 2-të të jetës dhe për të rinjtë. Për shkak të rasteve në rritje viteve të fundit të infeksioneve me Meningokok W dhe Y, rekomandimi për vaksinim kundër Sub-Tip C është zgjeruar në rekomandim kundër Meningokokeve ACWY: Për fëmijët e vegjël sipas mundësisë rekomandohet vaksinimi i vetëm në muajin 13. të jetës. Numri i nevojshëm i vaksinimeve të pjesëshme janë në varësi nga fillimi i vaksinimit dhe vetë vakcina. Ndërmjet moshës 11. dhe 13. vjeçare duhet të jepet një dozë shtesë 4-fish me vaksinë të konjuguar ACWY (shih gjithashtu “vaksinimet për nxënësit”).

Varicela (lija e dhenve)

Varicela nuk është një infeksion i padëmshëm, mbasi mund të shfaqen sëmundje të rënda përcjellëse. Prandaj vaksinimi rekomandohet përgjithësisht. Ajo bëhet në 2 pjesë me një distancë kohore të paktën prej 4-6 javësh. Ajo rekomandohet të merret në vitin e 2-të të jetës, por mund të bëhet edhe pas moshës 9 muajshe.

Vaksinimi kundër rriqrave (FSME)

Në Steiermark ka numër veçanërisht të madh të rriqrave, që mund ta transmetojnë virusin FSME. Prandaj, vaksinimi FSME është i rekomandueshëm pas përfundimit të moshës 1-vjeçare. Mbrojtja bazë arrihet me dy vaksinime të pjesëshme me distancë kohore nga 1-3 muaj dhe nga një vaksinim i 3-të pas 5-12 ose 9-12 muajsh (në varësi të vaksinës).

Hepatiti A

Vaksinimi rekomandohet për të gjithë fëmijët nga moshja 2-vjeçare – por veçanërisht përpara se të hyjë në një institucionin e përbashkët (si p.sh. kopësht për fëmijë, kujdestari). Pjesa e 2-të e vaksinimit pason në distancë kohore prej 6 muajsh. Sipas njohurive të tanishme ndoshta nuk do të jetë i nevojshëm rifreskimi i vaksinimit.

Moshat 6 deri 15 vjeç: Programi për vaksinim falas

Vaksinimet falas për moshat shkollore ofrohen nga mjekët/ mjekët rezidentë, në qendrat e vaksinimit të autoriteteve të rrethit, në qendrën e vaksinimit të Landit, në Bashkinë e Grazit dhe në shkolla. Nëse vaksinimet nuk mund të bëhen në shkollë, ju lusim të sigurohuni që ta vaksinoni fëmijën tuaj te mjeku rezident.

Në kuadër të vaksinimit falas për fëmijët shkollorë/ të rinjtë rifreskohen vaksinimet kundër difterisë, tetanozit, poliometilit dhe kollës së mirë, duke filluar nga viti i 7-të i jetës, respektivisht mund të bëhet imunizimi bazë kundër Hepatitit B që nuk është bërë. Rifreskimi i Hepatitit B është i këshillueshëm pas vitit të 8-të të jetës. Nëse p.sh. nuk është bërë vaksinimi kundër fruthit-shytave-rubeolës, atëherë medoemos duhet të bëhet një e tillë sa më shpejt që të jetë e mundur: Për mbrojtje të sigurt rekomandohen 2 vakcina të pjesëshme. Një mbrojtje e sigurt kundër rubeolës është në veçanti e rëndësishme për vajzat para se të ngelen shtatzënë. Vaksinimi kundër Humane-virusit të papillomës njerëzore (HPV) ofrohet falas për vajzat dhe djemtë që pas moshës 9-të vjeçare deri në përfundimin e moshës 21-të vjeçare (datëlindja e 21-të). Një vaksinim i tillë mbron në shkallë të lartë ndërr të tjerash ndaj rrezikut nga kanceri i qafës së mitrës dhe nga lythet në organet gjenitale. Vaksinimi bëhet në 2 vakcina të pjesëshme në një distancë kohore prej së paku 6 muajsh. Për vaksinim mbrojtës kundër Meningokokeve nga moshja 11. – 13. vjeçare të jetës ofrohet falas vaksinimi 4-fish me vaksinë të konjuguar (ACWY). Vaksinimi rekomandohet edhe për

fëmijët më të mëdhenj/të rinjtë në rast të sëmundjeve të mëhershme ose si vaksinim në rast të udhëtimeve, por që atëherë duhet të paguhet vetë.

Vaksinimi kundër koronës është i mundur aktualisht (gjendja e planit të vaksinimit 2023/2024) për fëmijët nga moshë 6 vjeç, rekomandimi i përgjithshëm prej moshës 12. vjeç. Vaksinimi zvogëlon rrezikun për t'u sëmurë rëndë me COVID-19. Për më tepër, rreziku i pasojave afatgjata të sëmundjes (p.sh. Long COVID) është më i ulët te personat e vaksinuar sesa te të pavaksinuarit. Nëse COVID-19 shfaqet pavarësisht vaksinimit, sëmundja zakonisht është më e shkurtër dhe më e lehtë. Koha më e mirë për një vaksinim është vjeshtë/dimër. Vaksinat kundër COVID-19 po përshtaten vazhdimisht me variantet aktuale të virusit. Vaksinat e reja kundër Omicron-XBB janë në dispozicion që nga shtatori 2023. Vendimi për të bërë një vaksinë kundër koronës duhet të merret gjithmonë në konsultim me mjekun/ mjeken pediatër, duke marrë parasysh situatën individuale. Shih më shumë në <https://impfen.gv.at/impfungen/covid-19>

Influenza (gripi i vërtetë viral)

Vaksinimi rekomandohet dhe ka kuptim për fëmijët që nga moshë 7 muajshe. Në veçanti, fëmijët me rrezikshmëri të shtuar nga sëmundjet kronike të mushkërive, zemrës, metabolizmit, sëmundjet e veshkave dhe defekteve të lindura ose të fituara imunitare duhet të vaksinohen kundër gripit. Vaksinimi kundër gripit do të ofrohet falas në vjeshtë/dimër 2024/ 2025 përmes programit të vaksinimit (ÖIP) deri në moshën 18 vjeçare. Për këtë proces nuk ju duhet ndonjë kupon nga blloku i çeqeve.

Grupmoshat 6-15 vjeç: e rekomandueshme, por jo në programin falas:

Vaksinimi FSME është veçanërisht me kosto efektive dhe para se gjithash i rëndësishëm në Steiermark. Edhe vaksinimi në mbrojtje kundër lisë së dhënve (varicela), meningokokut B, respektivisht hepatiti A duhet të bëhet ose të plotësohet eventalisht në moshën shkollore.

TË RRITURIT

Programi falas i vaksinimit

Vaksinimi në mbrojtje kundër Koronës sipas planit të vaksinimit 2023/2024 lejohet për të gjitha grupmoshat mbi 6 muaj vjeç dhe është në dispozicion falas për të gjithë ata që duan të vaksinohen. Sapo vaksinat të dorëzohen në sasi më të mëdha, ato do të jenë në dispozicion për të gjithë ata që dëshirojnë të vaksinohen. Vaksinimi zvogëlon rrezikun për t'u sëmurë rëndë me COVID-19. Për më tepër, rreziku i pasojave afatgjata të sëmundjes (p.sh. Long-COVID) është më i ulët për personat e vaksinuar sesa për ata të pavaksinuar. Nëse COVID-19 shfaqet pavarësisht vaksinimit, sëmundja zakonisht është më e shkurtër dhe më e lehtë. Komplikimet, qëndrimet në spital dhe vdekjet gjithashtu mund të shmangen në masë të madhe. Mjekja/mjeku juaj ju informon me kënaqësi lidhur me vaksinat e veçanta, numrin e vaksinimeve dhe intervalet kohore të vaksinimit. Edhe vakcina Fruth/Rubeolë/Parotit është falas për të gjithë të rriturit. Vaksinimet e munguara 1 dhe / ose 2 të MMR-së mund të kompensohen brenda fushatës së vaksinimit falas në çdo moshë. Distanca kohore ndërmjet vaksinimit 1 dhe 2 është katër javë.

Të rriturit: e rekomandueshme por jo në programin falas:

Të rriturit duhet të rifreskojnë vaksinimin kundër difterisë-tetanosit-kollës së mirë dhe poliomielitit çdo 10 vite, - që nga moshë 60-vjeçare çdo 5 vite -. FSME duhet të rifreskohet çdo 5 vite, dhe që nga moshë 60-vjeçare çdo 3 vite. Personat nga moshë 50-vjeçare duhet të vaksinohen kundër herpes zoster (herpes), dhe kundër pneumokokëve (pneumoni), mbasi në këtë moshë rritet së tepërmi rreziku ndaj infeksioneve të rënda. Vaksinimi influenza ("gripi i vërtetë") rekomandohet për të gjithë të rriturit. Ajo duhet të ripërtërihet çdo vit, sepse vaksinat përshtaten çdo vit virozave të reja të gripit.

Rreziku i komplikacioneve nga vaksinimi

Vaksinimi është një proces, që është "imituar" nga natyra. Reaksionet në kuptimin e një „sëmundjeje vaksinore“ nuk mund të përjashtohen asnjëherë plotësisht. Prandaj rreziku dhe pasojat e mundshme të sëmundjeve „natyrale“ duhet të ballafaqohen me „rrezikun e mundshëm të vaksinimit“.

Për reaksione të mundshme nga vaksinimi dhe efektet anësore pyesni mjekun/mjekun tuaj ose lexoni informacionet profesionale në lidhje me përbërësit e vaksinës nën www.sozialministerium.at nën „Impfen“. Komplikacionet e rënda pas vaksinimit janë shumë të ralla për shkak të procedurave të forta të lejimit dhe procedurave të vazhdueshme të observimit. Mosmarrja e vaksinave është shumë më e rrezikshme. Vetëm vaksinimi mbron me të vërtetë!

Kur nuk duhet të vaksinohet fëmija juaj?

- në rastin e sëmundjeve akute fibrile dhe/ ose
- në rastin e alergjisë së ditur ndaj përbërësve të vaksinës nuk duhet bërë vaksinimi

Ju lutemi të informoni mjekun/mjekun tuaj ...

- nëse fëmija juaj ka „tendencë të përgjithshme“ ndaj alergjive (p.sh. neurodermiti, ekzema) ose nëse ekzistojnë sëmundje të tjera të mëparshme (kronike).
- se si janë „përballuar“ deri më tani vaksinimet dhe në qoftë se në kohën e vaksinimit është paraqitur ndonjë sëmundje infektive në mjedisin tuaj.

Në rastin e rrufës dhe/ose temperaturës së lehtë, do të vendosë mjekja/mjeku juaj pas ekzaminimit, nëse do të vaksinohet apo jo fëmija juaj.

Për pyetje të veçanta...

lutemi t'i drejtoheni Klinikës Universitare për Fëmijë në Graz (reparti i infektologjisë, Tel. 0316/385-13685) ose repartit për fëmijë në spitalin e landit LKH Hochsteiermark/Leoben (Tel. 03842/401-2438).

Informacione të mëtejshme në lidhje me vaksinimet do t'i gjeni në www.vorsorgemedizin.st, si edhe pranë Qendës Informuese për Mjekësi Udhëtimi dhe Vaksinim e Landit Steiermark (Tel. 0316/877-3577), ambulantës për vaksinim dhe qendres këshilluese për Mjekësi Udhëtimi pranë Med Uni Graz (Tel. 0316/385-73626 ose 0316/385-73628) dhe nga mjekja/mjeku juaj.

Nga faqja 19 do të gjeni kuponët e vaksinave:

Në barnatore, do të hiqet pjesa e jashtme e djathtë e kuponit. pjesa e kuponit hiqet në anën e djathtë. Te mjeku hiqen dy kuponat e ardhshëm; në bllokun tuaj mbetet vetëm pjesa e skajshme e majtë e pjesës së kuponit. Nëse shkoni te një mjek/ mjek tjetër dhe i tregoni bllokun e çeqeve të vaksinimit, ai do ta dijë menjëherë se cilat vakcina i ka marrë tashmë fëmija juaj.

Këtu janë informacionet pse vaksinat e veçanta janë të rëndësishme. Ato gjenden në pjesën e pasme të kuponëve të vaksinimit:

ROTAVIRUSET

... shkaktojnë diarre me të vjella, të vjella, diarre, shpesh edhe ethe, dhe eventualisht dhimbje veshi. Diarreja e rëndë (e holluar) me humbje të shpejtë të lëngjeve mund të çojë në "dehidrim" dhe dështim të qarkullimit të gjakut.

Kur nuk duhet të vaksinohet fëmija juaj?

Sëmundjet akute febrile, sistem imunitar i dobësuar, diarre, të vjella, sëmundje të rënda të zorrëve dhe deformime, intolerancë e njohur ndaj përbërësve të vaksinës. Meqenëse para së gjithash pas vaksinës së parë, gjatë disa ditëve me radhë virusët e vaksinës largohen me anë të jashtëqitjes, duhet të shmangët kontakti me personat me imunitet të lënduar dhe është e nevojshme higjiena e mirë e duarve pas ndërrimit të pelenave. Për më shumë informacion dhe efekte anësore të mundshme të vaksinimit, pyesni mjekun tuaj ose lexoni informacionin e specialistit në www.sozialministerium.at tek "Impfen". Informacione të mëtejshme mund të gjenden gjithashtu në: www.vorsorgemedizin.st

DIFTERIA

... është një sëmundje shumë e rrezikshme e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes. Mund të lajmërohen frymëzënia me ngulfatje, dëmtime të zemrës, qarkullimit të gjakut dhe veshkave dhe paraliza..

TETANUSI

... infeksion nëpërmjet plagëve të kontaminuara. Komplikimet: ngërçe të muskujve, paralizë respiratore.

KOLLA E MIRË (Pertusisi)

... shkakton kollë të rëndë me gulçim që zgjat me muaj të tërë dhe kërcënon jetën e foshnjave.

PARALIZA E FËMIJËVE (poliomieliti)

... mund të shkaktojë paralizë të përhershme tek fëmijët dhe të rriturit.

HEMOFILI INFLUENCAE B

...te fëmijët e vegjël shkakton më i shpeshtë i meningjtit purulent dhe inflamacionit të rrezikshëm të epiglottisit.

HEPATITI B

... transmetohet para së gjithash nëpërmjet gjakut të infektuar dhe objekteve të papastërta, marrëdhënieve seksuale të pambrojtura, por edhe gjatë lindjes nga nëna e infektuar tek foshnja. Sidomos tek foshnjat dhe fëmijët e vegjël shpesh me ecuri kronike deri në cirrozë dhe kancer të mëlçisë.

Për më shumë informacione dhe efekte anësore të mundshme të vaksinimit, pyesni mjekun tuaj ose lexoni informacionet specialistike në www.sozialministerium.at nën "Impfen". Informacione të mëtejshme mund të gjenden gjithashtu në: www.vorsorgemedizin.st

FRUTHI:

... një nga "sëmundjet e fëmijëve" më të rënda. Tek 1 në 10 fëmijë vjen deri te inflamacioni i veshit të mesëm ose inflamacion te mushkërive. Tek 1 në 1000 fëmijë vjen deri te inflamacion i trurit me rrezikun e dëmtimit të përhershëm.

SHYTAT:

... prekin përveç gjëndrrës parotide, por edhe vezoret dhe testikujt dhe kështu mund të shkaktojë infertilitet. Pasoja të tjera të mundshme: encefaliti ose meningjiti dhe shurdhim.

RUBEOLA:

Fëmijët që vuajnë nga rubeola rrezikojnë para së gjithash gratë shtatzëna ose fëmijën e tyre në mitër. Nëse nëna infektohet në muajt e parë të shtatzënisë, mund të shkaktohen deformime serioze.

Për më shumë informacion dhe efekte anësore të mundshme të vaksinimit, pyesni mjekun tuaj ose lexoni informacionin e specialistit në www.sozialministerium.at tek "Impfen". Informacione të mëtejshme mund të gjenden gjithashtu në:
www.vorsorgemedizin.st

PNEUMOKOKET

... transmetohen përmes spërklave nga një personi në tjetrin dhe shkaktojnë inflamacion të rëndë të mushkërive, meningjit, inflamacion të veshit të mesëm dhe helmim të gjakut. Foshnjat dhe fëmijët e vegjël kanë rrezikshmëri më të lartë. Ftohjet banale nxisin infeksionin. Vaksinimi është veçanërisht i këshillueshëm nëse ekziston një rrezik i shtuar i sëmundjeve të caktuara kronike, mangësi imunologjike kongjenitale ose të fituar, tek foshnjat e lindura para kohe dhe foshnjat me pengesa në zhvillim dhe fëmijët me implante kokleare. Të moshuarit/ moshuarat shpesh infektohen nëpërmjet fëmijëve ose personave me fëmijë.

Për fëmijët me çrregullime konvulsive ose konvulsione febrile rekomandohet dhënia e medikamenteve që ulin temperaturën; është i mundshëm dhënia paralele e vaksinimit të gjashtëfishtë; ekziston mundësi e shtuar e rrijës së temperaturës.

Për më shumë informacion dhe efekte anësore të mundshme të vaksinimit, pyesni mjekun tuaj ose lexoni informacionin e specialistit në www.sozialministerium.at tek "Impfen". Informacione të mëtejshme mund të gjenden gjithashtu në:
www.vorsorgemedizin.st

Impressum:

Landi Steiermark, Departamenti 8 Shëndeti dhe Përkujdesja, Friedrichgasse 9, 8010 Graz;
(DVR 0087122);

Konceptimi i përgjithshëm:: Conclusio PR-Beratungs Gesellschaft mbH, 8010 Graz, © 2024

Dr. Jasmin Novak, Konrad Lindner

Zbatimi teknik: at.software, Katzianergasse 10, 8010 Graz

Fotografite: Adobe Stock, Comstock, Fanninger, Lorber, Schiffer, Shutterstock

Printimi: Steiermärkische Landesdruckerei, 8020 Graz

Kostot e printimit i merr përsipër Landi Steiermark

Përkthimi: Kern Austria GmbH